



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

**VENDIM
Nr. 35, datë 14.10.2013**

**PËR MIRATIMIN E PËRQINDJES SË PAGESËS RREGULLATORE PËR
VITIN 2014**

Në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, neni 10, pika 1 dhe Metodologjisë “Për Vendosjen e Tarifave”, neni 13, pika 2, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Përqindja e pagesës rregullatore për operatorët që u miratohet ndryshimi i tarifave për vitin 2014 do të jetë :

- 0.8% për operatorët që mbulojnë më shumë se 50% të kostos totale;
- 0.6% për operatorët që mbulojnë deri në 50% të kostos totale.

Ky vendim hyn në fuqi më 01 janar 2014.

**KRYETARI
Avni Dervishi**